



REPUBLIKA E KOSOVËS \* REPUBLIKA KOSOVA  
KOSOVA CUMHURIYETI  
Komuna e Prizrenit \* Opština Prizren  
Prizren Belediyesi  
Kryetari i Komunës / Председник Општине  
Belediye Başkanı



01 Nr. 148/26 Dt. 26.03.2026



Republika e Kosovës  
Republika Kosova- Kosova Cumhuriyeti

Komuna e Prizrenit  
Opština Prizren – Prizren Belediyesi

Në bazë të nenit 13 dhe 58 pika b të Ligjit nr. 03/L-040, për Vetëqeverisje Lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr. 28/2008) dhe nenit 51 të Statutit të Komunës së Prizrenit nr. 01/011-5643, të datës 15.10.2008, pas kërkesës së Drejtorisë së Shëndetësisë, kryetari i Komunës, merr këtë:

### V E N D I M

1. Miratohet kërkesa e Drejtorisë së Shëndetësisë, për lejimin e hartimit të projektit kryesor për ndërtimin e Qendrës së Mjekësisë Familjare (QMF) në fshatin Piranë, kështu që, për këtë qëllim lejohet shpallja e tenderit për mbledhjen e ofertave përkatëse.
2. Ky projekt realizohet sipas kodit të planifikuar buxhetor të Drejtorisë së Shëndetësisë -mallra dhe shërbime.
3. Obligohet Drejtoria e Shëndetësisë, Sektori i Prokurimit dhe Drejtoria e Ekonomisë dhe Financave për zbatimin e këtij vendimi.
4. Ky Vendim hyn në fuqi që nga dita e nënshkrimit të tij.

Kryetari i Komunës  
Shaqir Totaj

- Vendimi iu dërgohet:
  - Drejtorisë së Shëndetësisë,
  - Drejtorisë së Ekonomisë dhe Financave,
  - Sektorit të Prokurimit,
  - Arkivës së Kryetarit.

